

Bankat hezitojnë të kreditojnë koncesionet

Problemi i tokës dhe kuadri ligjor, shkaku kryesor. Prifti i jep kurajë për HEC-et

ARD KOLA

Rasti i fundit me projektin e Skavicës, i cili dështoi për shkak të mungesës së fondeve, ka vendosur në gjendje alarmi autoritetet shtetërore. Një pjesë e mirë e projekteve koncesionare, kryesisht në fushën energjetike nuk po gjejnë mbështetje nga bankat, duke rrezikuar bllokimin e investimit dhe krijimin e një zinxhiri të rrezikshëm falimenti. Për këtë arsye, ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Dritan Prifti, ftoi institucionet financiare që të shikonin me përparësi sektorin e koncesioneve në vend, sidomos atë energjetik te hidrocentralet. Gjatë takimit të zhvilluar dje, shumë drejtues bankash paraqitën te ministri shqetësimet e tyre dhe arsyet e ngurrimit për të kredituar. "Pasi analizuam me kujdes situatën, dy vjet më parë vendosëm që sektori i koncesioneve në HEC-e të mos jetë prioriteti ynë. Shkaku ishte mungesa e seriozitetit që paraqisnin investitorët. Megjithatë, pasi dëgjua ministrin për garancitë që mund të japë, mendojmë të ndryshojmë strategjinë", tha drejtori i një banke tregtare. Një tjetër shtoi se do të kërkojë kohë nisja e kreditimit në sektorin e hidrocentraleve. Sipas drejtuesve të bankave private, maksimumi i financimit që mund të bëhet është deri në 30 për qind të kapitalit. Arsyeja e hezitimit lidhet me së shumti me problemet e pronës dhe kuadri ligjor, i cili konsiderohet tepër burokratik. Përfaqësuesi i Agjencisë së Koncesioneve (ATRAKO), Shkëlqim Kërlluku, pranoi disa nga problemet që shoqëron procesin, duke evidentuar faktin se vetëm për të nisur punimet nevojiten të paktën 17 leje dhe autorizime. Ftesa e ministrit Prifti ishte e drejtpërdrejtë: kreditoni sektorin, pasi ka leverdi.

"Kemi përfunduar draftin për ligjin për energjinë e rinovueshme, në këtë ligj do të fiksohet periudha e tarifës së subvencionuar dhe garantuar për 15 vjet, çka do të sjellë më shumë siguri për investitorët", u shpreh Prifti. Ministri pranoi se në fushën e energjisë ka ende disa probleme siç mund të jetë ai i pronave, por shtoi se, "frika për të mos u përfshirë në garë për kreditimin është e pajustificueshme, pasi tashmë ekziston kuadri ligjor dhe garancitë për kreditim".

Sa u takon bankave, problemi qëndron te mungesa e të dhënave në projekt, garancia e investitorit që nuk bind, apo qëndrueshmëria e objektit, i cili nis për një HEC dhe përfundon për dy-tre të tjera në të gjithë kaskadën. Por insistimi i qeverisë shkon më tej. "Nuk po ju kërkojmë të kreditoni projekte të mëdha. Ne e dimë që për ju nuk është problem financimi i HEC-ve të vogla deri në 10 mega. Prandaj ju ftojme që ta mbështesni sektorin", tha zv.ministri i Financave, Alfred Rushaj.

Të dhënat e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës tregojnë se janë planifikuar rreth 1,9 miliardë euro investime nga të cilat pritet prodhimi i 3 miliardë kilovat/orëve energji elektrike më tepër në vit. Gjithsej, nga 99 projekte të dhëna me koncesion 44 prej tyre janë zhvilluar në mënyrë pozitive. Aktualisht, në fushën e energjetikës, nga 263 hidrocentrale janë dhënë me koncesion 90 prej tyre, ndërsa 14 janë në proces.



Ministri:

Zgjasim lejen
po qe nevoja

Shumë investitorë rrezikojnë projektin, pasi u skadon afati i licencës. Qeveria e miraton licencën dhe brenda një viti duhet të nisë puna, por mungesa e financimit vë në rrezik projektin. Në këto kushte, ministri garanoi bankat se licencën mund ta shtyjë edhe një vit nëse është e nevojshme, mjafton që projekti të mos mbyllet. "Në të gjitha praktikë e koncesioneve në HEC-e, vetëm 5 investitorëve ua kemi mbyllur projektin, për shkak se licencat kishin dalë në shitje", tha ministri.

Takimi

Sistemi online, i pacertifikuar. APP, Cankja: Zgjidhje të shpejtë

Biznesi, frikë nga tenderët elektronikë: Sabotohen ofertat

Sistemi elektronik i zhvillimit të tenderëve paraqet një sërë problemesh të evidentuara nga biznesi. Në takimin e zhvilluar dje me Agjencinë e Prokurimit Publik, organizuar nga Unioni i Dhoma-ve të Tregtisë, bizneset i paraqitën drejtoreshës Klodiana Cankja një sërë shqetësimesh. Problemi i parë qëndron te siguria e ofertave, të cilat paraqiten përmes internetit në faqen zyrtare të APP-së. "Kush më garanton që oferta ime nuk është zbuluar nga konkurrenti përmes lidhjeve që ka me institucionin. Kush jep siguri për sistemin elektronik, ndaj të cilit nuk kam asnjë informacion rreth certifikimit të tij", tha përfaqësuesi i një kompanie në fushën e teknologjisë së informacionit. Për drejtuesen e APP-së, përgjigjja nuk ishte shumë e thjeshtë, dhe në fund përmendi faktin se tani në muajin shkurt do të përzgjidhte kompania që do të certifikojë sistemin elektronik.

Një tjetër problem po aq i madh është vlerësimi i ofertave nga persona që nuk kanë eksperiencën e duhur, apo që nuk janë të fushës. "Si mund ta vlerësojë ofertën time një juri, anëtarët e të cilës nuk kanë ndoshta as shkollë apo njohuri të duhura, duke më hedhur poshtë të gjithë punën", u ankua një tjetër biznes, kësaj here në fushën e ndërimit. Cankja vuri

1900 ankesa

Nga 1900 ankesa të ardhura nga operatorët ekonomikë, mbi 90% e tyre janë konkluduar në rivlerësime apo edhe anulim të procedurave. Mbi 50% e tyre anojnë nga ana e operatorëve ekonomikë. Numri i ofertave të përfunduara nga operatorët ekonomikë për vitin 2009 arriti mbi 69 mijë.



në dukje se rol të rëndësishëm në zhvillimin e tenderëve ka edhe profesionalizimi i bizneseve. "Ka shumë rëndësi fakti i përgatitjes dhe profesionalizimi i biznesit, sa i takon hartimit të dokumenteve në tender. Jeni ju që ankoheni për padrejtësi në tenderë dhe jeni po ju që duke u ankuar i zvarrisni qëllimisht procedurat, me qëllim mundësinë e ndonjë përfitimi", tha shefja e APP-së.

Duke u ndalur te ligji i ri i prokurimit publik, një firmë e huaj ngriti shqetësimin sa i takon procedurës së ankesës. "Sipas ligjit të ri, ne duhet të paguajmë para se të bëjmë apelimin. Kjo nuk më duket e drejtë. Tjetër fakt

pengues për investitorët është afati i paraqitjes së ankesës në gjykatë, nga 30 ditë në 5 ditë, që nuk është i mjaftueshëm për të përgatitur ankesën", tha një investitor i huaj. "Tarifat janë vendosur për të frenuar ankesat pa fund e logjikë të biznesit. Kush pretendon me të vërtetë që është bërë padrejtësi në tender, le të paguajë, dhe nëse fiton, i kthehet shuma. Këtë praktikë ndjekin edhe vendet e tjera. Kurse sa i takon afatit të ankesës, gjykoj se 5 ditë janë të mjaftueshme, pasi gjykata konsiderohet hallka e tretë e ankimit dhe presupozohet që dokumentet janë gati", u përgjigj Cankja.

A.Kola

Kredia

Bode bind BERZH-in për 50 milionë euro



Për dy ditë radhazi, Ministria e Financave zhvilloi negociatën me BERZH-in, rreth kredisë 50 milionë euro, e cila do të financojë rrjetin rrugor. Pas diskutimeve dyditore rreth kushteve të kredisë e procedurave të zbatimit të projektit, u firmosën minutat e negociimit. Kredia në shumën prej 50 milionë euro pritet të bëhet efektive pas miratimit final në Bordin e BERZH dhe ratifikimit në Parlamentin Shqiptar rreth muajit maj të këtij viti. Kredia prej 50 milionë eurosh nga BERZH është pjesë e një projekti të koordinuar prej 137 milionë eurosh që do të mbështesin projektin e qeverisë shqiptare "Rrugët Dytësore dhe Lokale", i cili është në zbatim që prej vitit 2008. Projekti do të jetë bashkëfinansim me një tjetër kredi nga Banka Europiane e Investimeve me po 50 milionë euro dhe me grante të Bashkimit Europian nga IPA 2010 e 2011 me shumën prej 33 milionë euro. Një grant prej 4 milionë euro nga "Western Balkan Investment Framework" do të mbulojë kosto të tjera të lidhura me projektin si projektim-supervizion, asistencë teknike etj. Rreth 650 km rrugë dytësore e lokale parashikohet të rindërtohen nga ky projekt gjatë 5 viteve të ardhshme. Projekti "Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale", është një bashkëfinansim i Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë dhe po realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me një vlerë të përafërt prej 400 milionë dollarësh. Aktualisht janë në proces implementimi 210 km rrugë rajonale dhe lokale, ndërkohë që gjatë vitit 2010, parashikohet që të jenë rehabilituar apo të jenë nën rikonstrukcion 340 km rrugë. Janë hartuar projektet teknike dhe dokumentacionet për prokurimin e 400 km, si dhe është përfunduar me sukses inventarizimi i 3500 km rrugë rajonale dhe lokale duke ndërtuar një program që do të ndihmojë veçanërisht në priorizimin e investimeve bazuar në kriteret objektive teknike.

Pollo:

Celulari 4, shumë shpejt në treg

Shqipëria përgatitet të ketë shërbimin e operatorit të katërt celular, në një treg me 3.3 milionë banorë. Sipas ministrit të Shtetit, që mbulon telekomunikacionet, Genc Pollo, operatori i ri do të hyjë në treg brenda pjesës së parë të vitit 2010. Futja në treg parashikon të sjellë ulje të tarifave për bisedat celulare, të cilat në tre vitet e fundit janë reduktuar me rreth 20 për qind, për shkak të konkurrencës. Sipas ministrit, 34.4 për

qind është rritja ekonomike gjatë tremujorit të fundit në sektorin e telekomunikacionit në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. "Me futjen e një operatori të katërt gjatë, pritet të sjellë zhvillime të rëndësishme në këtë treg ekonomik", tha Pollo. Të tjera shërbime të reja do të jenë teknologjia 3G për navigimin në internet, apo mbartja e të njëjtit numër nga klienti edhe në rast të ndryshimit të kompanisë celulare.